

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Isa Kelmendi, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit B. D. nga ..., të cilin me autorizim e përfaqëson A. Ç., avokat nga ..., kundër të paditurës Qendra Klinike Universitare e Kosovës në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson A.A., objekti i kontestit anulimi i vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kompensimit të ardhurave personale, duke vendosur përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2311/17 datë 7.11.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 1.10.2018, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar revizioni i të paditurës, Prishen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2311/17 datë 7.11.2017 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2288/2015 datë 18.4.2017, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2288/2015 datë 18.4.2017, nën pikën I të dispozitivit është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është anuluar si i kundërligjshëm vendimi i të paditurës me nr. ..., të datës ..., dhe vendimi ..., i datës ..., i komisionit disiplinor të paditurës si dhe vendimi ..., i datës ..., dhe vendimi ..., i datës ..., i komisionit të ankesave të paditurës. Vërtetohet se paditësi është në marrëdhënie pune të rregullt pranë të paditurës me vendimin nr..., të datës ...

Nën pikën II të dispozitivit, është obliguar e paditura që paditësin ta kthejë në vendin e tij të punës Drejtor i shërbimit klinik të kardiokirurgjisë me të gjitha të drejtat e marrëdhënies së punës duke ia paguar pagat në lartësi prej 760 €, duke filluar nga data 1.8.2015 deri në pagesën përfundimtare. Është obliguar e paditura që paditësit në emër të shpenzimeve procedurale të

paguaj shumën prej 424 €, të gjitha këto kërkesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin e saj, pjesërisht ka aprovuar ankesën e të paditurës dhe ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së shkallës ë parë në pjesën sa i përket pasusit të parë, të tretë dhe të katërt të dispozitivit dhe ka gjykuar: vërtetohet se paditësi është në marrëdhënie pune me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës sipas kontratës së punës të datës ..., me çka detyrohet e paditura ta kthejë paditësin në vendin e punës mjek – specialist në shërbimin e kardiokirurgjisë dhe kirurgjisë vaskulare të QKUK-ës. Detyrohet e paditura që paditësit për pagat e pa paguara sipas kontratës së punës, në kohë të caktuar për pozitën e drejtorit të shërbimit të Klinikës së Kardiokirurgjisë dhe Kardiologjisë Invazive, t'ia paguaj pagat e pa paguara, duke filluar nga data e largimit nga vendi i punës 07.8.2015 e gjer në datën e përfundimit të kontratës 15.9.2017, në shumat mujore prej 760 € neto.

Në pjesën sa i përket pasusit të II-të dhe V-të të aktgjykimit të ankimuar, ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi në këtë pjesë vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë, në afatin ligjor ka paraqitur revizion e paditura, duke goditur të njëjtin për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të jo plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të dy aktgjykimet të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Në përgjigje në revizion i autorizuari i paditësit ka propozuar që revizioni i të paditurës të refuzohet si i pabazuar dhe aktgjykimi i goditur të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në kuptim të nenit 215 të LPK-së, ka gjetur se:

Revizioni i të paditurës është i bazuar.

Në procedurë të zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar fakti se paditësi ka qenë emëruar si Drejtor i shërbimit Klinik i Kardiokirurgjisë në QKUK, dhe se me vendimin e të paditurës me nr. ..., të datës 19.5.2015, paditësi është larguar për kohësisht nga puna për shkak të mungesës së licencës për punë. Me vendimin e të paditurës me nr. ..., të datës 30.6.2015, paditësit i është shqiptuar masa disiplinore e uljes në pozitë dhe se kundër këtij vendimi paditësi ka paraqitur ankesë të cilën komisioni i ankesa e QKUK-së ka refuzuar. Me

vendimin e të paditurës nr. ..., të datës ..., paditësit i shqiptohet masa disiplinore e ndërprerjes së marrëdhënies së punës kundër të cilit paditësi ushtron ankesë të cilën komisioni i ankesave të paditurës e vërteton me vendimin e saj me nr. ..., datë Të gjitha këto masa disiplinore i janë marrë paditësit nga fakti se paditësit i ka munguar licenca për pozitën e kirurgut specializuar të kardiokirurgjisë.

Në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore të ndërprerjes së marrëdhënies së punës të paditësit, janë bërë shkelje të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi që paditësi nuk ka marrë përgjigje në pretendimet ankimore që ka paraqitur ndaj vendimit për ndërprerjen e vendimit të marrëdhënies së punës dhe me këtë paditësit i është shkelur e drejta për përdorimin efikas të mjeteve juridike. Njëherit, me rastin e marrjes së vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit, i njëjti është diskriminuar në bazë të nenit 5 të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi(nr 05/L-021). Duke marrë parasysh se është anuluar vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit, gjykata e shkallës së parë ka detyruar të paditurën që paditësin ta kthejë në detyrat e punës në Klinikën e Kardiokirurgjisë dhe Kardiologjisë si dhe të shpërblejë dëmin në emër të pagave të pa paguara.

Gjykata e shkallës së parë vlerëson se vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë nr. ..., të datës 29.6.2015 paraqet licencë për ushtrimin e profesionit si kirurg i specializuar të Kardiokirurgjisë.

Gjykata e shkallës së dytë, me rastin e vendosjes me ankesë të paditurës të njëjtën ka refuzuar pjesërisht duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj dhe duke vlerësuar se vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë me nr. ..., të datës ..., paraqitet si licencë për ushtrimin e profesionit të kirurgut të specializuar në kardiokirurgji.

Gjykata Supreme e Kosovës një vlerësim të tillë të Gjykatës së Apelit nuk mund ta pranojë nga arsyeja se aktgjykimi i goditur përmban shkelje nga neni 182 par.1 pika (n) të LPK-së, pasi që aktgjykimi i goditur nuk përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për marrjen e një vendimi të drejtë dhe se me rastin e vendosjes në këtë çështje juridike kemi zbatimin e gabuar të drejtës .

Aktgjykimi i goditur nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare që kanë të bëjnë me vlerësimin e afatshmërisë së padisë së paraqitur sa i përket vendimeve mbi largimin e përkohshëm nga puna me nr. ..., datë 19.5.2015 dhe vendimit mbi uljen në pozitë me nr. ..., datë 30.6.2015, pasi që në bazë të nenit 78 të Ligjit të punës nr. 03/L-212 është përcaktuar se i

punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën nga marrëdhënia e punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi për realizimin e drejtave të shkelura dhe se punëdhënësi është i obliguar që të vendosë sipas kërkesës së të punësuarit në afat prej 15 ditësh dhe se vendimi i tillë duhet t'i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar në afatin prej 8 ditësh. Në bazë të nenit 79 të Ligjit në fjalë, çdo i punësuar i cili mendon se i janë shkelur të drejtat e tij ose nuk merr përgjigje në afat nga neni 78 par. 2 të këtij Ligji, në afatin vijues prej 30 ditësh mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore.

Përveç kësaj, si gjykata e shkallës së dytë dhe ajo e shkallës së parë nuk kanë vlerësuar se vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë nr. ..., të datës ..., a është ekuivalent me licencën për ushtrimin e profesionit të kirurgut të specializuar të kardiokirurgjisë dhe atë në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 10/2003 që është kusht për ushtrimin e profesionit të mjekut në specializim të caktuara dhe a janë zhvilluar procedurat në kuptim te nenit 5 -7 të udhëzimit në fjalë .

Prandaj, gjykata e shkallës së parë në vendosje të serishme duhet të vlerësojë afatshmërinë e padisë të paraqitur nga ana e paditësit kundër vendimit mbi largimin e përkohshëm nga puna, vendimin mbi uljen në pozitë si dhe të vlerësojë se e paditura me rastin e marrjes së vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit a ka pasur rregullore për procedurat e përgjegjësisë disiplinore dhe materiale, me të cilat parashikohet për shkak të mungesës nga puna mund të shqiptohet masa disiplinore ndërprerjes së marrëdhënies së punës pasi që Ligji i punës nuk përcakton si shkelje të rëndë të detyrave të punës mungesat nga puna e këtë e lë që punëdhënësi ta rregullojë me akte të përgjithshme. Pas vërtetimit të këtyre fakteve, gjykata e shkallës së parë duhet të vendosë lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Nga arsyet e dhëna më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 224.2 të LPK-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.115/2018 datë 01.10.2018

Kryetari i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri